

EDATA.AL shpk

NUIS : M01418014R

Adresa : Rruga Tanush Frasheri, Pallati Nr.147, Shk.Nr.1, Ap Nr.15, Tiranë

KONTRATE

SHITJE KUOTASH TE KAPITALIT THEMELTAR

Në Tiranë, sot më datë 12.10.2020, pranë selisë së shoqërisë u realizua akti i shitjes së kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë **EDATA.AL shpk**, si mëposhtë vijon:

SHITES: **HUBITER shpk**, përfaqësuar nga Z.Suela Kristaq Ciko, e cila është njëkohësisht ortaku i vetëm i shoqërisë "HUBITER" shpk me NUIS L81910028P, e cila është zotëruese e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "EDATA.AL" sh.p.k dhe ortak i vetëm i saj identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me Nr. personal **J25203083H**. Me zotësi të plotë për të vepruar.

BLERES: **Aleksander Viktor Gjoka**, i datëlindjes 25.06.1954, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me Nr. personal F406251170. Me zotësi të plotë për të vepruar.

Shitësi Hubiter shpk është ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "EDATA.AL"sh.p.k dhe zotëron 1(një) kuotë me vlerë 6 831 650 lekë, që përbën një pjesëmarrje në përqindje prej 100% të kapitalit fillestar, sipas ekstratit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit lëshuar nga QKB, më datë 12.10.2020.

Shoqëria **EDATA.AL shpk** është e regjistruar pranë QKB me NUIS M01418014R, ushtron aktivitetin e saj me seli në Tiranë, Rruga Tanush Frashëri, Pll. nr 147, shk nr.1, ap. nr.15, me objekt veprimtarie : Furnizimi i website-ve, web-hosting, mirembajtjes nedistance te programeve dhe pajisjeve; furnizimi me software dhe perditesimi i tyre; furnizimi i imazheve, teksteve dhe informacioneve dhe vlefshmeria e bazeve te dhenave (database); Dizenjim software-i, Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh software; Testim software; Dizenjim dhe zhvillim sistemesh te komunikimit; Dizenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise; Zhvillim sistemesh migrimi; Permiresim/upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, suportu i perdorimit dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software.

Shitësi HUBITER shpk miraton se i shet blerësit Aleksander Gjoka, gjithë pjesën e tij në total që përbën vlerën e 1(një) kuote dhe 100 % të kapitalit.

Cmimi i shitjes për 100% të kapitalit, që përbëhet nga 1(nje)kuotë është përcaktuar në masën 6 831 650 (gjashtë milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë, shumë e cila do të likuidohet me bankë për një periudhë kohore prej 5-vitesh.

Blerësi z.Aleksander Gjoka është dakord që të blejë këtë kuotë kapitali me cmimin e mësipërm duke u bërë kështu ortak i vetëm i shoqërisë "EDATA.AL"sh.p.k, **dhe do të**

EDATA.AL shpk

NUIS : M01418014R

Adresa : Rruga Tanush Frasheri, Pallati Nr.147, Shk.Nr.1, Ap Nr.15, Tiranë

zotërojë kuotën e vetme të kapitalit themeltar, pra 100% të kapitalit themeltar që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Kësaj kontrate i bashkëngjitet edhe vendim me nr. 1 datë 12.10.2020, i asamblesë së ortakëve të shoqërisë "EDATA.AL" sh.p.k.

Kontrata bazohet në nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 73 të ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Shitësi

HUBITER shpk

Suela Ciko

Suela Ciko


Blerësi

Aleksander Gjoka

Aleksander Gjoka
